



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 105, Datë 23.05.2025

MBI

**ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S LIDHUR ME SHQYRTIMIN
E KËRKESËS SË SHOQËRISË “SPV BLUE 2” SH.P.K. PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3, të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregulator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.05.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1497/7 prot., datë 23.05.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

Për qëllime të shqyrtimit të këtij Aplikimi janë ndjekur procedurat dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Paraqitja e Kërkesës për Licencim

- Shoqëria “SPV BLUE 2” sh.p.k. ka paraqitur në ERE, më 10.04.2025, kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Më pas, më 15.04.2025, ka dorëzuar mandatin e pagesës së aplikimit, çka shënon edhe fillimin e llogaritjes së afatit të shqyrtimit të këtij aplikimi.

2. Fillimi i Procedurës së Licencimit

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 84, datë 24.04.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- Në datat 25.04.2025 dhe 26.04.2025, ERE publikoi njoftimin për fillimin e procedurës në median e shkruar dhe në faqen zyrtare të internetit.
- Deri më datë 05.05.2025, datë kur përfundoi afati për paraqitjen e komenteve apo objeksioneve nga të tretët, nuk rezultoi të ketë patur të tilla.

3. Kërkesa për Dokumentacionin Plotësues

- Me shkresën nr. 1496/4 prot., datë 30.04.2025, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës së licencimit, si dhe i ka bërë me dije dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim.

4. Dorëzimi dhe Vlerësimi i Dokumentacionit Plotësues

- Më 5 maj 2025, shoqëria “SPV BLUE 2” sh.p.k. ka dorëzuar në ERE, përmes e-maileve të protokolluara, dokumentacion plotësues të aplikimit, i cili është paraqitur edhe fizikisht. Pas shqyrtimit, u kërkuar sqarime dhe dokumente shtesë për mbështetjen financiare dhe planin e biznesit, përmes shkresës së ERE-s të datës 12.05.2025. Në përgjigje, më 19.05.2025, shoqëria njoftoi se kishte bashkëngjitur planin e përditësuar të biznesit, por dokumenti mungonte. Gjithashtu, kërkoi disa ditë shtesë për dorëzimin e dokumentacionit të mbështetjes financiare.

5. Shtyrja e Afatit të Vendimarrjes

- Referuar nenit 14, pika 3 të Rregullores, bordi i ERE-s mund të zgjatë afatin e vendimarrjes deri në 30 ditë, kur dokumentacioni nuk është i plotë.
- Për gjithë sa më sipër, vlerësohet të pranohet kërkesa e shoqërisë dhe të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimarrjes së bordit të ERE-s për aplikimin e saj për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Brenda 20 (njëzet) ditëve shoqëria duhet të depozitojë në ERE planin e biznesit të përditësuar dhe dokumentacionin përkatës të mbështetjes financiare.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimarrjes së bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “SPV BLUE 2” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin e munguar brenda 20 (njëzet) ditëve.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “SPV Blue 2” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI